



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353-121834

Dt. 24.10.2016

**DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR**, me kërkesën e **Kadri Kovanci** nga **Prizreni** me banim në rrugën **“Ismet Jashar Kumanova”** në bazë të nenit 3 alineja 1 pika 1.7,1.17,1.24 si dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1, si dhe neni 14 alineja 1 pika 1 si dhe në lidhje me nenin 15 nënparagrafi 1.1, neni 19 alineja 2 e lidhur me nenin 25 të Ligjit për ndërtim me nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, si në kuptim të nenit 11,12,13,14,15,16 dhe 17 të Udhëzimit Administrativ 09/2013, konform nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82,83,84,85. e në lidhje me nenin 86. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

## AKTVENDIM

I. **I LEJOHET: Kadri Kovanci** për ndërtimin e objektit - **lokalit afarist me etazhitet P+1** në rrugën **“ Ismet Jashar Kumanova”** në vendin e ashtuquajtur **/** në ngastrën kadastrale **4219** sipas dokumentacionit teknik e cila është e hartuar nga ana e **byrosë projektuese N.P.N. “ ALBING ”**.

- II. Sipërfaqja e përgjithshme ndërtimit të godinës sipas skicës së kopjes së planit është **23** m2.
- III. Sipërfaqja bruto e godinës është **47.17** m2.
- IV. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit **të veçant**.
- V. Paralogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacionit teknik kap shumën prej **17029.15** €.
- VI. Ndërtimi i objekteve ndihmëse s’është e lejuar si dhe vlera e këtyre objekteve, është përjashtuar nga paralogarit e vlerës së objektit.
- VII. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë me shkrim organin kompetent (inspektionin e ndërtimtarisë) në afat prej 8ditësh.
- VIII. Pas përfundimit të ndërtimit të objektit investitori duhet të parashtojë kërkesë për marrjen e lejes për përdorim.
- IX. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se investitori me punë nuk fillon brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e lëshimit të lejes së ndërtimit.
- X. Kunjëzimi i objektit, si dhe nivelizimi i themeleve të bëhet sipas dimensioneve të skicuara në kopjen e planit të lëshuar nga kjo Drejtori.
- XI. Pronarët e pronave fqinje kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e dhënies së lejes së ndërtimit (shikimin e dokumentacionit)
- XII. Investitori është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte, ngase është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK, KEDC-it, Dukagjinit dhe avari tjera ti evitoj dhe ti kthej në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejt kompensimi.

## A r s y e t i m

**Parashtruesi i kërkesës: : Kadri Kovançi** nga **Prizreni** me banim në rrugën **“ Ismet Jashar Kumanova”** i është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes së ndërtimit për ndërtim të **objektit - lokalit afarist** .

Duke shfletuar dokumentacionin teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara këtij organi s’bashku me kërkesë vërtetohet se:

Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Që parashtruesi i kërkesës ka miratuar të gjitha pagesat rreth ndërtimit të objektit si dhe s’bashku me kërkesë në shtojcë ka parashtruar këto dokumente të duhura: kopjen e planit, listën poseduese, dëftesë pagesat që i ka paguar kontributet për rregullimin e tokës ndërtimore si dhe projektet.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi ndërtim e të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes së ndërtimit.

Nga se u tha më lartë u marr aktvendimi si në dispozitiv.


**KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE**; Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, përmes këtij organi.

Ankesa taksohet me 0.50 Euro taksa administrative.

Bashkëpunëtor profesional:



**Afërdita Mormorina, inxhi. dip. ark.**



**DREJTORI**

  
**Visar Islamaj**